



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.118, Datë 04.04.2023

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “ECO - ELB” SH.A., PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 KW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 44 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/5 prot., datë 30.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ECO - ELB” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1843 prot., datë 09.11.2022, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), me kapacitet të instaluar 2850 kW.
- Sa konstatuar, aplikimi i shoqërisë është depozituar sipas afatit të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Sa më sipër, pas përmbushjes së kritereve formale ligjore, është vlerësuar që në përputhje me përcaktimet e gërmave “b” dhe “d” të nenit 44 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është njoftuar shoqëria mbi sa konstatuar për kontratën e qirasë.

- Pas korrespondencës së zhvilluar ndërmjet ERE dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., në lidhje me statusin e rinovimit të kësaj kontrate, rezulton se me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 137/4 prot., datë 27.03.2023, shoqëria ka depozituar në ERE: Kontratën e rinovuar të qirasë, me nr. 1027 prot., datë 10.03.2023, të nënshkruar mes Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Qiradhënësi) dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. (Qiramarrësi). Në pikën 4 të kësaj kontrate përcaktohet se ajo lidhet me një afat 1-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, nga 28.03.2023 deri më datë 27.03.2024, me të drejtë rinovimi.
- Në këto rrethana, vlerësojmë se janë plotësuar të metat e kërkesës dhe veprimet e nevojshme për fillimin e procedurës, në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 44 të KPA-së.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16, formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); si dhe të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të Rregullores dhe nuk rezulton debitorë ndaj ERE-s përsa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “ECO - ELB” sh.a. rezulton i plotësuar si vijon:
 - Neni 16 Rinovimi i licencës, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por ERE kushtëzohet nga afati i kontratës së qirasë përsa i përket afatit të vlefshmërisë që do të ketë ky rinovim licence, pra deri më datë 27.03.2024.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO- ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW, me afat deri më datë 27.03.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI